

## KONTAKTE DHE NDIKIME FRËNGE-SHQIPTARE /SH.XI-XVIII/

*Veli Veliu*

Prishtinë

KUD 394.9(=919.83:=40)  
Punim studimor

Marrë për botim, më 22 nëntor 1994

**Përmbajtja e shkurtër:** Bëhet fjalë për kontakte dhe ndikime frënge-shqiptare të cilët janë të llojllojshme: diplomatike, ushtarake, tregtare, letrare, kulturore dhe kanë lënë gjurmë në shumë aspekte të jetës dhe krijimtarisë së të dy popujve.

Me gjithë distancën gjeografike relativisht të madhe, në mes të francezëve dhe shqiptarëve ka patur kontakte që nga shekulli XI e deri në ditët tona. Ato kanë qenë të natyrave të ndryshme: diplomatike, politike, ushtarake, tregtare, kulturore, letrare dhe kanë lënë gjurmë në shumë aspekte të jetës dhe krijimtarisë së të dy popujve. Sipas karakterit ato të përiudhës prej mbarimit të shekullit XI deri në fund të atij XVIII mund të ndahen në kontakte të mëhershme dhe të mëvonshme.

### **I.Kontakte të mëhershme/sh.XI-XVIII/**

Kontaktet e mëhershme janë të drejtpërdrejta dhe të imponuara për shqiptarët. Në këtë periudhë feudalët normanë dhe anzhuinë të Mbretërisë frënge të Sicilisë ndërморën shumë aksione ushtarake kundër Perandorisë Bizantine, kurse shumica e tyre u zhvilluan në territorin shqiptar i cili në atë kohë ishte pjesëpërbërës i kësaj perandorie. Ndër aksionet e para të tilla në Shqipëri ishte ajo e pranverës së vitit 1081 kur armata normane e udhëhequr nga Robert Giskari /Robert Guiscard/ dhe i biri i tij Boemoni /Bohémond/ zbarkoi në Vlorë dhe në Korfuz dhe, pasi i pushtoi edhe shumë qytete të tjera shqiptare, e rrethoi Durrësin, një nga portet më të rëndësishme të Adriatikut. Pas rezistencës afër njëveçare ajo e pushtoi edhe këtë qytet dhe shumë të tjerë të cilët Mbretëria frënge e Sicilisë i mbajti nën pushtetin e saj deri në vitin 1083.

Kontakt tjetër mjaft masiv gjatë këtij shekulli ndodh trembëdhjetë vjet më vonë apo gjatë Kryqëzatës së Parë kur tri ekspedita kryqëtarësh frëngë ia mësynë Shqipërisë në rrugë për në Lindjen e Afërt. E para nga Provansa e udhëhequr prej Rejmon dë Tuluzë /Raymond de Toulouse/, pasi kalon Normandinë, Istrinë dhe Dalmacinë, hyn në Shqipëri, nëpër Shkodër, kurse e

dyta, pasi e kalon Italinë, nga Deti Adriatik, zbarkon në Durrës. Që të dyja, pas disa ditësh, e vazhdojnë rrugën nëpër Luginën e Shkumbinit apo Rrugën Mbretërore, siç quhej rruga e vjetër Via Egnatia, duke u furnizuar me ushqim dhe udhërrëfyes nga banorët e këtyre viseve. Ekspedita e tretë e udhëhequr nga Boemoni prej Italisë së Jugut zbarkon në Vlorë dhe Himarë dhe, pas disa ditëve, edhe ajo e vazhdon rrugën nëpër luginat e Vjosës dhe Devollit për në Lindjen e Afërt.<sup>1</sup>

Ambiciet pushtuese të feudalëve normanë të Mbretërisë frënge të Sicilisë vazhduan edhe në shekullin XII. Kështu, në vitin 1107, Boemoni përsëri e sulmoi Shqiperinë duke u nisur, në krye të armatës së tij, nga Apulia për të zbarkuar në Vlorë prej nga, edhe këtë herë, e rrethoi Durrësin, por pa sukses. Në përpjekjet për t'i shtënë në dorë këtë qytet dhe shumë qytete të tjera, këtë radhë i ndihmuan edhe shumë shqiptarë të lodhur nga sundimi bizantin. Megjithatë, i raskapitur nga këto përpjekje apo lufta, ai lidhi paqe me Bizantin dhe së shpejti /1108/ u tërhoq nga Shqipëria.

Për herë të fundit, dyzet e një vjet më vonë, normanët e Mbretërisë frënge të Sicilisë përsëri depërtuan në tokat shqiptare. Këtë radhë flota e Rozhe II/Roger II/ zbarkoi në Shqipëri dhe i shtiu në dorë shumë qytete bregdetare të këtij vendi, por së shpejti u detyrua të tërhiqej nga ishte nisur.

Siç dihet, kah fundi i shekullit XII, Mbrtëria frënge e Sicilisë kaloi nën tutorinë e perandorëve gjermanë kurse, në vitin 1266, nën atë të mbretërve të Shtëpisë Anzhu, të cilët, përsa i përket politikës ndaj Bizantit apo ambicieve pushtuese, nuk dalluan gati aspak nga normanët. Kështu, posa Karli I i Francës /Charles I/ arriti ta fuste në dorë Sicilinë, ai u hodh në pushtimin e Shqipërisë ku hasi në rezistencë të madhe jo vetëm të feudalëve shqiptarë, por edhe të tërë popullatës. Por, për dallim nga paraardhësit e tij frëngë, në realizimin e politikës së tij pushtuese, ai u tegua më elastik dhe më pak brutal. Kështu, vetëm pas negociatave të gjata me feudalët shqiptarë të cilëve u garantoj paqe dhe privilegje, arriti ta pushtojë një pjesë relativisht të madhe të Shqipërisë të cilën, më 21 shkurt 1272, e shpalli "Mbretëri të Arbërisë"/ Regnum Albaniae/, kurse veten mbret të saj. Krijesa e tillë politike shqiptare në fillim i përfshinte vetëm tokat brenda trekëndëshit Durrës-Berat-Vlorë, kurse më vonë edhe shumë të tjera të kësaj ane.<sup>2</sup> Karli I u mundësoi feudalëve, qoftë shqiptarë ose francezë, t'i zgjeronin pronat e tyre gjë që edhe këtu, si edhe gjetiu në Evropën e kësaj kohe, shkonte në dëm të fshatarëve dhe në përgjithësi të masave të gjera popullore. Megjithëkëtë, feudalët shqiptarë nuk ishin të kënaqur me pozitën e vazallit. Prandaj ata shpeshherë i mobilizuan masat në luftë kundër pushtuesit të huaj. Kështu, për shkak të këtyre trazirave, të presionit bizantin dhe të vështirësive në vetë Mbretërinë frënge të Sicilisë, pas sundimit pesëmbëdhjetë vjeçar, anzhuinët u tërhoqën nga Shqipëria.

Por prania anzhuine në këtë anë të Ballkanit nuk do të marrë fund me kaq. Pas përgatitjeve të gjata, Filip dë Tarantë/Philippe de Tarante/, nipi i Karlit I, i pushtoi përsëri qytetet Durrës/, Vlorë e të tjerë dhe e përtëriu "Mbretërinë e Arbërisë" /1304/. Në politikën e tij pushtuese edhe ai u mbështet në feudalët e

<sup>1</sup> Shih *Historia e popullit shqiptar*, I, Rilindja, Prishtinë, 1969, f.167-168.

<sup>2</sup> *Aty*, f.188-189.

mëdhenj shqiptarë, të cilëve u garanoi zotërimi tokash dhe privilegje të tjera. Në administratën e lartë angazhoi edhe shqiptarë, duke u dhënë tituj kontësh dhe mareshalësh. Por këtë radhë planet e anzhuinëve për të zgjeruar dominimin në këtë pjesë të Ballkanit hasën në kundërshtim me ato të mbretit serb, Millutinit, kundër të cilit, me ndihmën e Papës, formuan një lloj koalicioni ku morën pjesë edhe shumë feudalë shqiptarë. Kundër këtij rreziku edhe Roberti, pasardhësi i Karlit I, u mbështet po ashtu në feudalët shqiptarë të cilët, në të shumtën e rasteve, u bënë një lloj vazalësh anzhuinë. Kështu, Tanush Topia, një ndër këta feudalë, në vitin 1338, u shpall sovran i një territori mjaft të gjerë me titullin kont dhe e grabiti dhe u martua me Helenën, të bijën e Robertit. Pas vdekjes, i biri i tij Karli i zgjeroi edhe më tepër territoret duke u bërë plotësisht i pavarur.

Kështu mori fund prania e tillë frënge në Shqipëri e cila zgjati, me ndërprerje, më se tre shekuj. Edhe pse francezët këtu vijnë si pushtues, marrëdhëniet shqiptaro-frënge shpeshherë janë miqësore. Por sidoqoftë ato janë kontakte të gjata, mjaft masive dhe të drejtpërdrejta dhe si të tilla kontribuojnë në njohjen reciproke të këtyre dy popujve në shumë aspekte. Natyrisht ato nuk janë vetëm të natyrës ushtarake. Përveç ushtarëve dhe diplomatëve në Shqipëri vijnë edhe tregtarë, priftër, udhëshkrues e të tjerë. Në saje të këtyre dhe kontakteve të tjera, shqiptarët arrijnë t'i njohin francezët nga shumë aspekte, si mënyrën e jetesës, marrëdhëniet shoqërore feudale, doket e zakonet, kulturën e të tjerë. Gjatë kësaj kohe letërsia frënge dita më ditë bëhet më e pasur duke krijuar vepra të zhanreve të ndryshme me kualitete ideo-artistike mjaft të larta. Edhe pse filozofia dhe shkencat e tjera janë nën kthetrat e kishës, ato arrijnë shkallë mjaft të lartë të zhvillimit. Është plotësisht e mundur që vepra apo ide të tilla të kenë dëpërtuar edhe të shqiptarët e kësaj epoke.

Që nga shekulli XIII, përveç familjes së «Principatës së Arbërisë», fillojnë të dalin në skenë edhe shumë të tjera, si ajo e Arvanitëve, Muzakajve, Topiajve, Dukagjinëve. Ato arrijnë të krijojnë principata qoftë vazale ose të pavarura. Nën ndikimin frëng feudalët shqiptarë, dikush më pak e dikush më shumë, në principatat e tyre krijojnë marrëdhënie shoqërore të tipit perëndimor, marrëdhënie të reja në mes të klasave, në mes të sovranit dhe vazalëve etj. Siç përmendëm, ata marrin edhe tituj si kont, mareshal e të ngjashëm. Në oborret e tyre depërtojnë edhe manire të ndryshme frënge të sjelljes së njerëzve në përgjithësi. Gjatë shekujve XIII-XIV, Durrësi, Shkodra, Vlora dhe qytete të tjera, në pikëpamje ekonomike dhe kulturore, arrijnë nivel relativisht të lartë zhvillimi. Krahas të mëparshmeve hapen edhe shkolla të reja të cilat, si edhe gjetiu, janë nën kthetrat e kishës kurse Franca, "e bija e dashur e kishës", e cila gjithmonë ka pasur ndikim në Ballkan,<sup>3</sup> nëpërmjet këtyre institucioneve ndikon edhe te shqiptarët. Natyrisht në këto qendra dhe institucione kanë jetuar dhe kanë punuar njerëz të shkolluar ose të ngritur, klerikë, arsimtarë e të tjerë të cilët sigurisht e kanë njohur letërsinë, kulturën dhe të arriturat e tjera në lëmenj të ndryshëm të shkencës dhe kulturës.

Kontaktet e tilla u mundësuan francezëve t'i njohin prej së afërmi Shqipërinë dhe shqiptarët, marrëdhëniet e tyre shoqërore, doket e zakonet,

3 K.S.Chandan, *L'Influence de la littérature française dans les Balkans*. Paris, 1940, f.39.

civilizimin. Pa dyshim, si rezultat i këtyre kontakteve është edhe romani, "Chronique de l'excellent roy Floriment"/Kronika e mbretit të shkëlqyeshëm Florimon/ të Emon de Varenit /Aimon de Varennes/, shkruar në vitin 1184.<sup>4</sup> Për një konkludim të tillë na bind sidomos fakti që ngjarjet e kësaj vepre zhvillohen më së shumti në Shqipëri dhe shumica e personazheve janë shqiptarë.<sup>5</sup> Përndryshe ky është roman avanturesk i tipit të "Floire et Blanchefleur"/Fluar dhe Blanshfler/, "Aucassin et Nicolette"/ Okaseni dhe Nikoleta/, "Tristan et Iseut" /Tristani dhe Izolda/ të cilët ishin shumë në modë në këtë kohë në Francë. Është vepër jo aq e vëllimshme, e thurur në vargje tetërrokëshe me rimë çifte.

Në lidhje me ngjarjet historike të viteve 1081-1083, kur Robert Giskari zbarkoi në Shqipëri dhe arriti ta pushtonte një pjesë të madhe të saj, udhëshkruesi frëng, Koloneli Beker/Le colonel Becker/<sup>6</sup> përpiqet ta shpjegojë prejardhjen e emrit të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Në rrugë për në Ohër, ai kaloi me armatën e tij nëpër Elbasan që, sipas Bekerit, në këtë kohë, quhej Albanopolis. Kështu, "ushtarët e Robertit, duke mos e njohur gjuhën e vendit, për shkak të kontakteve të vogla me vëndësit, i japin emrin Albania rajonit ku Albanopolis ishte qytet më i rëndësishëm, dhe ky emër, i sjellë nga ai në Itali, u zgjerua pak nga pak në gjithë vendin e banuar nga raca së cilës i takonin edhe banorët e rrethit të Elbasanit".<sup>7</sup>

Gjatë kësaj kohe në Shqipëri qëndrojnë ose nëpër të kalojnë, zakonisht në rrugë për në Lindje, priftër dhe udhëshkrues të ndryshëm frëngë. Atyre u interesonte t'i shënonin apo t'i përshkruanin peizazhet e vendit, e sidomos përshtypjet në lidhje me popullin dhe vendin e tyre. Një nga këta njerëz është edhe Gijemus Adae /Guillemus Adae/, i cili në vitin 1332 e shkruan në gjuhën latine veprën "Directorium ad passagium facienda" të cilën Xho Milo/Jo Milot/ e përkthen në frëngjishte me emrin "Avis directif pour faire le passage d'outré-mer" /Njoftim për ata që duan të udhëtojnë përtej detit/ ku gjenden shënime të ndryshme shumë të rëndësishme mbi shqiptarët e Veriut, të cilat janë rezultat i qëndrimit të tij gjashtëvjeçar /1324-1330/ si kryepeshkop i Tivarit.

## II. Kontakte të mëvonshme/ sh. XV-XVIII/

Kah fundi i shekullit XIV, në Shqipëri si edhe gjetiu në Ballkan, raporti i fuqive ndryshoi plotësisht. Me gjithë rezistencën e madhe të popujve të kësaj ane, Turqia arriti t'i pushtojë gati të gjitha territoret bizantine të kësaj pjese të kontinentit të vjetër. Për shkak të pozitës gjeo-strategjike, e sidomos të rezistencës së shqiptarëve në krye me heroin e tyre legjendar Skënderbeun, Shqipëria u bë një lloj dige në mbrojtjen e Evropës Perëndimore prej invazionit turk.

Gjatë njëzet e pesë vjetve /1443-1468/, Skënderbeu arriti t'i mposhte më se 22 fushata turke gjë që në Evropë ngjalli respekt dhe admirim ndaj

<sup>4</sup> Shih **Floriment**, *Cronique de l'excellent roy Floriment*, Lyon, 1555.

<sup>5</sup> Shih **Ruzhdi Usharku**, *Roman i shekullit XII me syzhe shqiptar ballkanik*. "Rilindja" e 3.11.1984, f.12-13.

<sup>6</sup> Ka qëndruar në Shqipëri në vitet e shtatëdhjeta të shekullit XIX.

<sup>7</sup> Le colonel **Becker**, *L'Albanie et les Albanais*. Paris, E.Dentu, 1880.

shqiptarëve, e veçanërisht ndaj heroit të tyre. Kështu, prej kësaj kohe kontaktet shqiptaro-frënge u bënë plotësisht miqësore dhe reciproke. Meqë interesat ishin reciprokë, në këto vite të rezistencës, u krijuan marrëdhënie diplomatike në mes të Shqipërisë dhe disa shteteve evropiane, duke përfshirë këtu edhe Mbretërinë frënge të Napolit dhe Francën. Në këto marrëdhënie duhet përmendur sidomos aleancën dhe miqësinë e Skënderbeut me Alfonsin V të Madh /Alphonse V le Grand/, mbret i Aragonit dhe Sicilisë dhe me birin e tij, Ferdinandi I, mbret i Sicilisë. Ata e ndihmuan njëri-tjetrin por edhe ndihma e këtyre dy mbretërive ishte më tepër e karakterit moral sesa ushtarak ose material. Kështu Alfonsi V i akordoi trimit dhe strategut tonë një pension prej 1.500 dukatë në vjet<sup>8</sup>. por nuk e paguajti plotësisht. I dërgoi edhe 2.000 ushtarë këmbësorë, të cilët morën pjesë në pushtimin e kështjellës së Beratit.

Skënderbeu nuk e harroi këtë të mirë. Me rastin e një kryengritjeje të banorëve të Italisë së Jugut kundër Ferdinandit I /1460/ ai i dërgoi "një kontigjent kalorësish shqiptarë duke i premtuar se së shpejti do të vinte edhe vetë".<sup>9</sup> Një kundërshtari të këtij mbreti frëng, i cili e luti që të mos merrte pjesë në këtë konflikt, Skënderbeu iu përgjigj se "nuk mund të harronte ndihmën që i kishte dhënë Alfonsi në luftën kundër turqve ia bërë me dije se pa luftën e suksesshme që kishin bërë shqiptarët, jo vetëm Shqipëria por edhe Italia do të kishte kaluar nën zgjedhën e osmanlinve".<sup>10</sup> Kështu, gjatë gushtit të vitit 1461 u nis për në Itali në krye të një armate shqiptarësh prej 2.500 ushtarësh. Ai arriti në Napoli në momentin më kritik për Ferdinandin të cilit i kishin ngelur të papushtuara vetëm ky qytet dhe dy fortesa të tjera. Heroi shqiptar i sulmoi befas dhe i shpartalloi kryengritësit në Barleta dhe i ndjeku ata edhe nga qytetet e tjera. Dhe pasi ia ktheu Ferdinandit territoret e pushtuara dhe paqen, me plotë falenderime dhe mirënjohje, u kthye në Shqipëri.<sup>11</sup>

Gjatë kësaj kohë edhe Franca tregoi interesim mjaft të madh për luftat e Skënderbeut dhe të shqiptarëve edhe pse ndihma e saj ishte gati simbolike. Kështu, me rastin e rrethimit të parë të Krujës, ajo hyri në luftë kundër Turqisë gjë që e lehtësoi mjaft rezistencën shqiptare. Përveç kësaj mbreti i Francës së kësaj kohe, Filipi III /Philippe III le Bon/ e ndihmoi Shqipërinë edhe materialisht. Sipas Marin Barletit, ky mbret, papati dhe mbreti hungarez i dërguan Skënderbeut «një shumë mjaft të madhe floriri dhe argjenti sepse e dinte mirë se, për shkak të luftave të gjata, kishte nevojë për një ndihmë të tillë».<sup>12</sup>

Mbreti frëng tregoi simpati ndaj Skënderbeut dhe shqiptarëve. Në Kongresin e Mantovës / 1459/, të organizuar me iniciativën e papës, ai shprehu dëshirën për të luftuar në anën e tyre kundër turqve. Përndryshe, hero i shqiptar tanimë ishte bërë i njohur në Francë dhe gjetiu edhe në popull. Kështu, në një nga aksionet e shumta të rezistencës, shumë vullnetarë erdhën në Shqipëri për t'u inkuadruar në armatën e këtij njeriu dhe strategu të madh, duke përfshirë këtu edhe «më se pesëdhjetë galë».<sup>13</sup>

<sup>8</sup> Histori e popullit shqiptar I, vep. cit. f. 275.

<sup>9</sup> Aty, f. 280.

<sup>10</sup> Aty, f. 279.

<sup>11</sup> Aty, f. 280.

<sup>12</sup> Marin Barleti, *Skënderbeu. Historia e jetës dhe e veprave*. Prishtinë, 1967, f. 289.

<sup>13</sup> Marin Barleti, *vep. e cit.* f. 234.

Interesimi i Francës dhe në përgjithësi i Evropës së krishterë ndaj Shqipërisë vazhdoi gjatë kohë edhe pas vdekjes së Skënderbeut, sepse populli i saj vazhdoi rezistencën edhe gjatë dyzet vjetve të ardhshëm duke treguar heroizëm të madh. Më vonë, pasi Turqia e dobësoi këtë rezistencë, ajo ndërmoi një ekspeditë të madhe /1480/ për ta pushtuar Italinë. Më se dhjetëmijë ushtarë turq zbankuan dhe, pas një rrethimi të shkurtër, e pushtuan Otrantën. Meqë Italia konsiderohej si pikënisje për pushtimin e vendeve të tjera, kjo ngjarje e tronditi tërë Evropën e krishterë. Prandaj në këtë kohë u formua një koalicion evropian për luftë kundër këtij rreziku permanent. Ferdinandi I, shef i koalicionit, i ftoi shqiptarët për të luftuar edhe më me ngulm kundër turqve. Për këtë qëllim i biri i Skënderbeut, Gjon Kastrioti, i cili ishte strehuar në Mbretërinë frënge të Napolit pas vdekjes së të atit, kaloi në Shqipëri ku u prit mirë duke u konsideruar si princ dhe prijës i saj. Turqia angazhoi një ushtri të madhe kundër kryengritësve shqiptarë, e cila u shpartallua keq. Gjatë kësaj kohe /1481/, duke përfituar nga vështirësitë në Shqipëri, ushtritë e dukës së Kalabrisë arritën ta fusin përsëri në dorë qytetin e Otrantës. Në këtë mënyrë shqiptarët kontribuan shumë në dëbimin e turqve nga Italia, gjë që e shtoi edhe më tepër famën e tyre në tërë Evropën.

Por meqë kjo nuk i dha fund rrezikut, Evropa Perëndimore, duke përfshirë këtu edhe Francën, organizoi edhe shumë ekspedita të tjera kundër Turqisë duke i ftuar shqiptarët të çoheshin më shpesh dhe më me ngulm kundër këtij armiku të përbashkët. Një nga këto ndërmarrje është edhe ajo e Karlit III /Charles III/ më 1494 për të zbankuar në Itali, gjë që e nxiti edhe më tepër entuziazmin e këtij populli për luftë kundër turqve. Sipas Faik Konicës, i cili sigurisht është bazuar në "Chroniques de Louis XII" /Kronikë e Luigjit XII/ të Zhan Doton/ Jean D'Auton/,<sup>14</sup> "në ushtrinë e Luigjit XII u formua një gardë prej 1.200 shqiptarësh, të cilët treguan trimëri aq të madhe sa që u bënë simbol i armatave franceze për afër një shekull të tërë".<sup>15</sup> Prandaj, padyshim, thuhet se «në shekullin XVI kur francezët donin të lëvdonin ndonjë kalorës thoshin:» ai kaluron posi shqiptar». <sup>16</sup>

Ambicia për të zgjeruar kufijtë ngeli edhe më tutje në plan të parë në politikën e sulltanëve. Gjatë shekujve XVI dhe XVII turqit dy herë e rrethuan Vjenën. Kështu sytë e tërë Evropës së krishterë ngelën të drejtuar kah ky rrezik. Në anën tjetër shqiptarët shpeshherë u çuan kundër tyre duke u përgjigjur gjithmonë ftesave të Evropës Perëndimore. Një situatë e tillë ndikoi që francezët ta konsideronin gjatë kohë Turqinë si rrezik potencial e shqiptarët si popull heroik gjithmonë në luftë kundër tij. Por kur në shekullin XVIII ai u zvogëlua apo u mënjanua, edhe simpatitë dhe interesimi u zbeh mjaft. Kjo do të zgjasë deri kah fundi i këtij shekulli kur do të krijohen rrethana të reja politike e të tjera, të cilat do të ndikojnë që Shqipëria dhe Ballkani përsëri të jenë në qendër të interesimit të Francës dhe e kundërta.

Siç shohim, gjatë kësaj periudhe, kontaktet dhe marrëdhëniet shqiptaro-frënge ishin shumë më të dendura dhe krejtësisht miqësore. Në këtë pikëpamje duhet veçuar sidomos marrëdhëniet në mes të Skënderbeut dhe

<sup>14</sup> Jean D'Auton, *Chroniques de Louis XII*. Paris, 1890-1895, viti 1500.

<sup>15</sup> Faik Konica, *Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Buzuku, 1991, f. 117.

<sup>16</sup> Aty, f.14.

Alfonsit V me të birin e tij Ferdinandin. Përveç kontakteve ushtarake e diplomatike kanë ekzistuar edhe të natyrës tregtare, kulturore etj., e sidomos me Mbretërinë frënge të Napolit. Megjithatë, edhe pse jo aq të zhvilluara, marrëdhënie të tilla kanë ekzistuar edhe me Francën. Përsa i përket tregtisë, sipas asaj që thotë Pukëvili, në vendin e galëve janë importuar agrumine, drithëra, lesh të papërpunuar, dru për ndërtim të anijeve. «Franca, e cila gjithmonë ka pasur marrëdhënie tregtare me Shqipërinë, para Revolucionit, nga atje merrte për çdo vjet shumë anije me dru ndërtimi dhe këto dru, shumë më të mira se ato të Balltikut, përpunoheshin në kantierët e Tulonit. Fregatat tona më të mira janë ndërtuar me drutë e Shqipërisë»<sup>17</sup> Kurse nga ky vend në Shqipëri janë importuar stofe, armë zjarri, bizhuteri.<sup>18</sup> Shkëmbimet e tilla kanë mundësuar kontakte dhe vizita tregtare të te dy palëve.

Në këto disa shekuj në Shqipëri kanë qëndruar, shumë më tepër se më parë, njerëz të pendës, priftër, diplomatë, udhëshkrues e të tjerë. Por, edhe pse ky vend u bë i njohur me rezistencën heroike të shqiptarëve me Skënderbeun në krye, numri i këtyre të fundit, edhe gjatë kësaj kohe, ishte i vogël. Arsyet ishin të shumta: anarkia që ishte e pranishme në gjithë Perandorinë osmane, bandat e ndryshme kusarësh, mungesa e rrugëve dhe e urave të përshtatshme, teket e bejlerëve. Në këtë pikëpamje gjendja ishte edhe më e vështirë në brendinë e vendit ose në viset malore. Përndryshe edhe këta, si edhe të mëparshmit, ishin udhëshkrues rasti. Të preokupuar me misione të ndryshme, në rrugë për në Lindje ose në Levant, ata shënonin nga diçka që mund të zgjonte kureshtjen te lexuesit e tyre: ndonjë detaj për viset apo qytetet nëpër të cilët kalonin, për të kaluarën shqiptare, për gjuhën.

Kështu, në veprën. «Le Voyage de Terre sainte»/ Udhëtimi për në tokën e shënjtë/, Deni Paso /Denis Passot/ u kushton disa faqe Shqipërisë dhe banorëve të saj.<sup>19</sup> Në "Le Voyage du Levant"/ Udhëtimi për në Levant/ të Dë Frensë Kanej Filip /De Frense Canaye Philippe/ hasen të dhëna për Kosovën dhe Shqipërinë e Jugut.<sup>20</sup> Zhan Palern Foresien /Jean Palerne Foresien/ i përshkruan shqiptarët si trima dhe luftëtarë të shkëlqyeshëm duke i krahasuar me francezët.<sup>21</sup> Zhil le Buvie/Gille le Bouvier/ bën ca përshkrime interesante të Shqipërisë dhe të Moresë, të cilat për të janë vende të pasura dhe atraktive.<sup>22</sup> Kështu, edhe nëpërmjet shkrimeve të tyre, lexuesit frëngë patën mundësi të njoftohen, në shumë aspekte, me këtë popull të vjetër të Ballkanit.<sup>23</sup>

Rol të rëndësishëm, në këtë pikëpamje, luajtën edhe shkrimet frënge për Skënderbeun. Duke filluar prej shekullit XVI e deri vonë në atë tonin jeta dhe bëmet e tij u bënë objekt trajtimi i shumë monografive historike, biografike dhe

<sup>17</sup> Pouqueville, *Voyage en Morée, à Constantinople, en Albanie...*, pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801. Paris, Chez Gabon et comp., 1805, vëll. 3, f.181.

<sup>18</sup> Aty, f.180-183.

<sup>19</sup> Denis Passot, *Voyage de Terre Sainte/ dorëshkrim/*, 1532, f.117.

<sup>20</sup> De Frense Canaye Philippe, *Le Voyage du Levant*, Ernest Leroux, Paris, 1575.

<sup>21</sup> Jean Palerne Foresien, *Pérégrinations*, Lyon, 1606, f.429,449,495

<sup>22</sup> Gille lex Bouvier, *Recueil des voyages et des documents depuis le XIII à XVI siècle/ dorëshkrim/*.

<sup>23</sup> Për disa nga këta udhëshkrues shih dr. Gjyltekin Shehu, *Disa të dhëna frënge mbi shqiptarët/ shek.XIII-XVI/*, Separat. Prishtinë, 1979, f.287-293.

i kronikave të ndryshme si dhe burim frymëzimi i dhjetra shkrimtarëve të zhanreve të ndryshme.

Për një ekspansion të këtillë të heroit tonë në Francë kontribuoi shumë vepra e Zhak dë Lavardenit /Jacques de Lavardin/, "Histoire de Georges Gastriot, surnommé Scanderbeg, roy d'Albanie" /Historia e Gjergj Kastriotit, të mbiquajtur Skënderbe, mbret i Shqipërisë/<sup>24</sup> e botuar në vitin 1576, e cila, edhe pse është një përshtatje /në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale/ e asaj të Marin Barletit, "Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut",<sup>25</sup> sipas kriterëve të asaj kohe, u konsiderua origjinale dhe mjaft e rëndësishme. Si e tillë ajo zgjoi interesim të madh te lexuesit kështu që, për një kohë relativisht të shkurtër, u ribotua gjashtë herë dhe me tirazh mjaft të madh për kohën. Në këtë mënyrë ajo jo vetëm që e popullarizoi mjaft heroin tonë në këtë vend por u bë burim informimi edhe i shumë autorëve të zhanrit të tillë e të ngjashëm si edhe letrar.

Megjithatë, kjo nuk është vepra e parë në gjuhën frënge që u shkrua dhe u botua për Skënderbeun. Që në vitin 1544, Gijom Golteron dë Sankuen/Guillaume Gaulteron de Cenquoins/ e botoi në Paris monografinë historike, «Scanderbeg..., traduit de Toscan en français»/ Skënderbeu..., përkthyer nga toskanishtja në frëngjisht/<sup>26</sup>. Siç tregon edhe vetë titulli, kjo është një përkthim i rëndomtë nga versioni italian i veprës homonime të Dhimitër Frëngut, e cila vetëm pesë vjet më parë ishte botuar në Itali.<sup>27</sup>

Para asaj të Lavardenit u botua edhe vepra e Andre Tëve /André Thevet/, «La Cosmographie universelle»/ Kosmografia universale/<sup>28</sup> e cila luajti rol po ashtu të rëndësishëm në njohjen e popullit dhe heroit tonë në Francë. Në pjesën kushtuar historisë së Perandorisë otomane ky erudit frëng i hap kllapat për t'i njoftuar lexuesit me njërin nga kundërshtarët më të mëdhenj të saj, Skënderbeun. Këtu ai bën fjalë për prejardhjen e tij, fëmijërinë, rininë dhe trimëritë, të dhëna që hasen si në veprën e Barletit, ashtu edhe në atë të Golteronit. Është interesant se Tëve e ndërpret rrëfimin e tillë më ngjarjet rreth rrethimit të parë të Krujës. Por këtë zbrazëti do ta plotësojë nëntë vjet më vonë /1584/ në veprën, "Les Vrais portraits et vies des hommes illustres" /Portretet e vërteta dhe jeta e njerëzve të famshëm/<sup>29</sup> e cila, siç tregon edhe vetë titulli, është një lloj biografie e më se dyqind njerëzve të mëdhenj të të gjitha vendeve dhe kohëve, si Homeri, Herodoti, Karli i Madh. Në vëll. II, libri IV, f.304-321 autori bën fjalë në formë të përmbledhur për fëmijërinë, rininë dhe bëmet e heroit tonë deri në vdekjen e tij. Përndryshe, edhe pse e shkruar nga dora e një eruditi, vepra në fjalë nuk ka ndonjë pretendim të madh për originalitet. Qëllimi i saj është vullgarizues.

<sup>24</sup> Histoire de Georges Castriot, surnommé Scanderbeg, roy d'Albanie..., Par Jacques de Lavardin. Paris, G.Chaudière, 1576.

<sup>25</sup> Marin Barleti, *vep.e cit.* e botuar për herë të parë në gjuhën latine në Romë rreth viteve 1508-1510.

<sup>26</sup> Scanderbeg..., traduit de Toscan en français par Guillaume Gaulteron de Cenquoins, Paris, 1544.

<sup>27</sup> Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë, 1968, f.131-132.

<sup>28</sup> La Cosmographie universelle d'André Thevet... Paris, 1575.

<sup>29</sup> Les Vrais portraits et vies des hommes illustres... par André Thevet. Paris, Y.Korvert et G.Chaudière, 1584.

Vepra të tilla u shkruan edhe në dy shekujt vijues. Kështu në vitin 1624 Nikolla Kosen /Nicolas Caussin/ e boton "La Cour sainte ou l'institution chrestienne"/ Oborri i shenjtë ose institucioni i krishter <sup>30</sup> e cila u prit me interesim të madh nga lexuesit. Ky qe shkaku sigurisht që ajo u ripunua dhe u ribotua shumë herë si edhe u përkthye në disa gjuhë të Evropës. Në versionin e dytë biografia e Skënderbeut, në krahasim me ato të shumë personaliteteve të shquara historike, zë vend mjaft të merituar.

Për t'i bërë edhe më interesante dhe tërheqëse veprat e tilla, disa autorë bëjnë edhe paralelizma në mes personaliteteve të ndryshme. Në këtë mënyrë, sipas ngjashmërive, heroi dhe strategu ynë i madh krahasohet me njerëz të ndryshëm të famshëm historikë. Kështu, duke e konsideruar shpëtimtar të civilizimit të Evropës së krishterë nga rreziku turk apo mysliman, në veprën e tij, «Les Hommes illustres» /Njerëzit e famshëm/ <sup>31</sup> Aleksandër dë Kampioni /Alexandre de Campion/ e krahasonm atë me Karl Martelin e famshëm frëng në luftë kundër arabëve në shekullin VIII. Unë e bëj këtë-thotë autori i këtij libri sepse «ndër të krishterët vetëm Skënderbeu mund të krahasohet me Karl Martelin». <sup>32</sup> Përndryshe, ai u gjind këtu pranë Klovisit, Karlit të Madh, Frederik Barbarosës, Henriut IV, Ferdinandit II etj.

Vepër tjetër e këtij lloji është «L'Abrégé de la vie des divers princes»/ Përmbledhje e shkurtër nga jeta e princëve të ndryshëm/ e Antuan Tesie /Antoine Tessier/ botuar në vitin 1710. <sup>33</sup> Është një përmbledhje biografish të pesë personaliteteve të famshëm të periudhave të ndryshme historike si ajo e Skënderbeut / f.143-184/, Alfonsit VI, Tumerlengut.

Në "Les Caprices de la fortune ou les vies de ceux que la fortune a comblé de ses favers"/ Kapricet e fatit ose jeta e atyre që fati u ka sjellë shumë të mira/ <sup>34</sup> Andrien Rishe /Andrien Richer/ bën fjalë për Skënderbeun në kuadër të rrëfimit për njerëzit e mëdhenj si Katerina II, perandoreshë e Rusisë, Alfredin, mbret i Aglisë, Kazimirin I, mbret i Polonisë. Është interesant se, para se të rrëfejë për heroin tonë, ai jep një pasqyrë të shkurtër për shtrirjen gjeografike të Shqipërisë dhe për disa tipare kryesore të shqiptarëve. "Të gjithë historianët pretendojnë të dëshmojnë-thotë ai- se shqiptarët janë degë e skitëve të vjetër. Ata janë shtathedhur, të fortë, të zhvilluar mirë dhe shumë të guximshëm, kurse kalorësia e tyre është më e mirë se këmbësoria". <sup>35</sup> Përndryshe ai bën paralele midis Skënderbeut dhe Gustav Griksonit, mbret i Suedisë.

Dhe kur është fjala për vepra të tilla duhet përmendur edhe atë të Zhan-Nikola Dyponse /Jean-Nicolas Duponcet/, «Historie de Scanderbeg, roy d' Albanie»/ Historia e Skënderbeut, mbret i Shqipërisë/, <sup>36</sup> botuar në vitin 1709. Në të autori bën fjalë për familjen, fëmijërinë, rininë dhe trimëritë e heroit tonë kombëtar duke u bazuar në të dhënat e Barletit, Kampionit dhe Kosenit. Vepra u ribotua disa herë gjë që flet për interesimin e madh të lexuesve.

<sup>30</sup> N. Caussin, *La Cour sainte*, ou l'institution chrestienne des grands... Paris, 1624.

<sup>31</sup> Les Hommes illustres de A.de Campion. Paris, Courbé, 1657.

<sup>32</sup> Aty, f.237.

<sup>33</sup> Abrégé de la vie des divers princes..., par Antoine Tessier, Amsterdam, 1710.

<sup>34</sup> Les Caprices de la fortune ou les vies de ceux que la fortune a comblé de ses faveurs..., par M.Richer, Paris, Belin 1786-1789.

<sup>35</sup> Aty, f.4.

<sup>36</sup> *Histoire de Scanderbeg, roi d' Albanie*, par J.N. Duponcet, Paris, J.Mariette, 1709.

Në këto vepra e të ngjashme, të shkruara sipas shijes së kohës, bëhet fjalë gati vetëm për bëmet e Skënderbeut e pak përmenden ose aspak ato të ushtrisë së tij apo të popullit shqiptar në përgjithësi. Këto njëanshmëri i ka vërejtur edhe Pukëvili. Ai befasohet si në të nuk është thënë asgjë për mirditasit trima, luftëtarë të paepur të heroit tonë të famshëm «të cilët i mundën aq herë Muratin dhe muhamedanë»/<sup>37</sup> Por, megjithatë, edhe kur nuk është thënë asgjë në këtë pikëpamje vetë fakti se Skënderbeu është shqiptar dhe ka luftuar për Shqipëri dhe në Shqipëri një gjë e tillë është nënkuptuar nga lexuesit.

Siç përmendëm, gjatë kësaj periudhe, Skënderbeu u bë burim frymëzimi letrar i shumë poetëve dhe shkrimtarëve frëngë në përgjithësi. U shkruan disa poezi/sonete, ode dhe stance/ me rastin e botimit të disa veprave të rëndësishme siç është ajo e Lavardenit dhe e Kampionit.<sup>38</sup> Në frymën e kohës u shkruan pesë romane, katër në shekullin XVII<sup>39</sup> dhe një në atë që vijon<sup>40</sup> si dhe një novelë<sup>41</sup> një tragjedi<sup>42</sup> një operë<sup>43</sup> etj.<sup>44</sup>

Edhe gjatë kësaj periudhe, si edhe më parë, nëpërmjet kontakteve të përmendura e të tjera, edhe shqiptarët arritën të njoftohen me të arriturat e francezëve në lëmenj të ndryshëm, e sidomos në letërsi, shkencë, kulturë. Në favor të këtij pohimi flet edhe një bisedë e Pukëvilit me një shqiptar të moshuar në Përmet. «Ai më rrëfen për udhëtimet e tij në Francë. E kishte vizituar kafenenë Procopé ku i kishte takuar dhe njohur Didëroin, Dalamberin, Frerenë dhe letrarët e shekullit të fundit. Ai citonte vargje të Rasinit, Korneut, Volterit dhe me një ekspozim shkencor më bindi se e njihte letërsinë tonë», thotë ky udhëshkrues.<sup>45</sup>

Por kur themi kështu mendojmë sidomos në atë që ndodhi në shekullin XVIII, atëherë kur në Shqipëri depërtuan idetë e iluministëve frëngë, filozofëve ose shkrimtarëve si Volteri, Rusoi, Monteskje. Gjatë kësaj kohe shumë shqiptarë studiuin në qendra të ndryshme universitare të Francës të cilët, pas mbarimit të studimeve, u kthyen në vendin e tyre ku punuan zakonisht si arsimtarë, priftër. Përveç tyre kishte edhe shumë të tillë që studiuin edhe në qendra të tjera të Evropës, si në Padovë, Romë, Lajpcig ku kishin depërtuar dhe depërtonin këto ide përparimtare frënge. Vatra të rëndësishme të përhapjes së tyre ndër shqiptarët u bënë edhe shkollat nëpër qendra të ndryshme të Shqipërisë si në atë të Janinës, Voskopojës, Shkodrës, Elbasanit. Edhe pse në shumicën e tyre

37 **Pouqueville**, *Voyage dans la Grèce*. Paris, Firmin-Didot, 1820-21, vëll. 2, f. 513.

38 Ndër këto janë edhe një sonet i **Ronsarit** që i prin veprës së **Lavardenit** dhe dy të **Korneut** që i prijnë asaj të **Kampionit**.

39 **Histoire Negre-pontique**, contenant la vie e les amours d'Alexandre Castriot..., par P. de Boissat, Paris, 1631; Scanderbeg/par U. Chevreau/, Paris, T. Quinet et de Sercy, 1644, 2 vëll.; Mémoires du Sérail, par M<sup>me</sup> de Villedieu, Paris, 1670-1673; Le Roman d'Albanie et de Sycile, par le sr Du Bail..., Paris, 1626.

40 Scanderbeg, ou les Aventures du prince d'Albanie/par Chevilly/, Paris, 1732, 2 vëll.

41 Le grand Scanderbeg, par M. de La Roche Guilhem, Amsterdam, 1688.

42 Scanderbeg, tragédie, par M. Dubuisson, mutulée sur le Théâtre-Français, le 9 mai 1786, ensuite par les journalistes.-Bruxelles et Paris, 1789.

43 Scanderbeg. Tragédie lyrique en 5 actes et un prologue en vers libres..., Par A. Houdar de la Motte. Paris, 1735.

44 Për veprat letrare, fusnotat 39-44, shih **Ymer Jaka**, *Skënderbeu në letërsinë frënge*. Prishtinë, 1990.

45 **Pouqueville**, *Voyage dans la Grèce*, vep. e cit. vëll. 1, f. 165.

mësimi zhvillohej në gjuhën greke ato luajtën rol të rëndësishëm në këtë pikëpamje.

Siç shohim, kontaktet dhe ndikimet shqiptaro-frënge, në forma të ndryshme, kanë ekzistuar që nga shekulli XI. Ato kanë qenë të dyanshme, të llojllojshme dhe të pandërprera. Vlejnë të përmenden ato të shekujve XIV-XVIII e sidomos frymëzimi letrar i shkrimtarëve frëngë në jetën dhe bëmet e Skenderbeut dhe ndikimi i iluministëve frëngë te shqiptarët. Pa dyshim, kontaktet, frymëzimi, ndikimi kanë kontribuar edhe në afrinë dhe miqësinë në mes të këtyre dy popujve.

*Veli Veliu*

#### DES CONTACTS ET INFLUENCES FRANCO-ALBANAIS/ XI<sup>e</sup> -XVIII<sup>e</sup>s./

#### R é s u m é

Malgré la distance géographique relativement grande, les contacts franco-albanais ont existé dès le XI<sup>e</sup> siècle jusqu' à nos jours. Ceux de la période de jusqu' à la fin du XVIII<sup>e</sup> siècle, comme les autres, ont été de la nature diplomatique, militaire, commerciale, culturelle, littéraire. Ils deviennent épais et amicaux surtout depuis l'époque du héros légendaire albanais Scanderbeg, alors quand l'Albanie sera au centre de l'intérêt non seulement de la France mais de l'Europe entière.

Les contcats qu'ils soient imposés ou amicaux, contribuent à la connaissance réciproque des deux peuples sous plusieurs aspects. A part les soldats et des diplomates, viennent en Albanie des commerçants, des prêtres, des voyageurs. Ici aussi les Français créent des rapports sociaux de type occidental, des rapports nouveaux entre classes, entre le souverain et le vassal. Ils arrivent à connaître sa population, ses moeurs et usages, sa civilisation. Comme résultat de cette connaissance est le roman d'aventure au sujet albanais-balkanique, «Cronique de l'excellent Roy Floriment, fils du noble Matakaz, duc d'Albanie» d'Aimon de Varennes écrit au XII<sup>e</sup> siècle. Ce qui est important c'est intérêt littéraire des Français pour Scanderbeg qui, dès le milieu du XVI<sup>e</sup> siècle à nos jours, devient en France l'objet d'inspiration pour plusieurs écrivains et le héros de dizaines d'oeuvres littéraires, sonnets, odes, romans, contes, tragédies, comédies et opéras.

